

Leximi ju bën udhëheqës

**Studimi nacional për vlerësimin e shkrim
leximit në fushë të gjuhës dhe njohurive
themelore matematikore në klasat fillestare në
Maqedoni**

Versioni i shkurtë i raportit

shkurt 2017

Përmbajtja:

1.	Hyrje.....	3
1.1	Popullata dhe mostra	4
1.2	Struktura e instrumenteve	5
1.3	Trajnimi për parashtrimin e detyrave të instrumenteve EGRA dhe EGMA	7
1.4	Mbledhja e të dhënave, përpunimi, analiza dhe raportimi.....	7
2.	Rezultate nacionale nga vlerësimi i gjendjes fillestare në shkrim lexim në fushë të gjuhës dhe njohuritë themelore matematikore	8
2.1	Karakteristikat e mostrës.....	8
2.2	Sa lexojnë mirë nxënësit në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke?	8
2.3	Sa i zhvillojnë mirë nxënësit shkathtësitë themelore matematikore?	12
3.	Rezultate longitudinale nga EGRA dhe EGMA	14
4.	Çka mësuam nga realizimi i EGRA-së dhe EGMA-së.....	16
5.	Rekomandime të rëndësishme për në të ardhmen	17
6.	Shtojca 1: Detyra në EGRA në gjuhë shqipe	21
7.	Shtojca 2: Detyra në EGMA për klasën e dytë dhe të tretë	24

Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabela 1. Numri i nxënësve të vlerësuar në mostrën nacionale dhe në atë longitudinale sipas klasave, gjinisë dhe gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.....	5
Tabela 2. Rezultate mesatare të nxënësve në detyrat EGRA dhe EGMA sipas klasëve dhe gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.....	10
Tabela 3. Rezultatet mesatare të nxënësve në detyrat EGMA sipas klasave	13
Tabela 4. Avancimi i nxënësve nga mostra longitudinal në lexim sipas klasave	15
Grafiku 1. Përqindja e nxënësve në mostrën për EGRA sipas: klasës, gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, vendndodhja e shkollë dhe gjinia.....	8
Grafiku 2. Përqindja mesatare e zgjidhjes së detyrave në EGRA për klasë të dytë	9
Grafiku 3. Përqindja mesatare e zgjidhjes së detyrave në EGRA për klasën e tretë	9
Grafiku 4. Përqindja mesatare e zgjidhjes së detyrave në EGMA.....	12
Grafiku 5. Krahasimi sipas klasave të përqindjes mesatare të zgjidhjes së detyrave në EGRA në klasat me mësim në gjuhë maqedonase.....	14
Grafiku 6. Krahasimi sipas klasave të përqindjes mesatare të zgjidhjes së detyrave në EGRA në klasat me mësim në gjuhë shqipe.....	14
Grafiku 7. Krahasimi sipas klasave të përqindjes mesatare të zgjidhjes së detyrave në EGMA	16

“Studimi nacional për vlerësimin e shkrim leximit në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore të nxënësve të klasave fillestare është i mundësuar me mbështetjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë amerikane për zhvillim ndërkombëtar – USAID. Përmbajtja e këtij raporti dhe rekomandimeve janë përgjegjësi e Fondacionit për iniciativë arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi” – Maqedoni, e cila e realizon projektin e USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës”, dhe të njëjtat nuk i shprehin qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1. HYRJE

Projekti i USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës” i realizuar nga Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi” – Maqedoni, në partneritet me institucionet arsimore shtetërore të Maqedonisë, në maj të vitit 2016 e realizoi studimin e parë nacional për vlerësimin e shkrim leximit në fushë të gjuhës, me instrumentin EGRA¹ dhe studimi nacional për vlerësimin e njohurive themelore matematikore me instrumentin EGMA. Mostra, për secilin instrument veçmas, ishte rreth 8000 nxënës nga klasa e dytë dhe e tretë nga të gjitha shkollat fillore me mësim në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke. Rezultatet të fituara nga ky studim japin informata të rëndësishme të cilat duhet të shfrytëzohen që të informohen përfaqësuesit e institucioneve arsimore për arritjet vijuese të nxënësve në fushën e gjuhës dhe matematikës dhe të hapet dialog me Ministrinë e Arsimit dhe institucionet tjera arsimore që janë relevante me qëllim që të përcaktohen standarde për arritje në lexim dhe matematikë në bazë të rezultateve mesatare të nxënësve.

Qëllimi i Projektit të USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës” është që të kontribuojë për përmirësimin e shkathtësive gjuhësore dhe matematikore të nxënësit e klasave fillestare, përforsimi i shkathtësive pedagogjike të mësimdhënësve, veçanërisht shkathtësitë për vlerësim diagnostik dhe formues, dhe ngritja e vetëdijes të tërë bashkësia për rëndësinë e shkrim leximit në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore për zhvillimin intelektual të fëmijëve.

Grupet e punës të formuara në kuadër të projektit, të formuar nga përfaqësues të institucioneve arsimore, profesor të fakulteteve pedagogjike dhe praktikant, i përshtatën dy instrumentet ndërkombëtare, për vlerësimin e shkrim leximit në fushë të gjuhës (EGRA) dhe për vlerësimin e njohurive themelore matematikore (EGMA), që na mundësojnë të shohim a kanë arritur nxënësit t’i përvetësojnë shkathtësitë themelore gjuhësore dhe matematikore në fund të klasës së dytë dhe të tretë, dhe nëse kjo nuk ndodh, në cilat fusha nxënësve duhet t’u mundësohet mbështetje shtuese.

Instrumentet EGRA dhe EGMA ishin pilotuar në dhjetor të vitit 2013 me vlerësimin e 1762 nxënësve të klasës së tretë dhe të katërt nga 22 shkolla fillore me mësim në gjuhë maqedonase dhe shqipe. Në vitin 2014 ishin mbledhur të dhëna për gjendjen fillestare me në shkrim lexim në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore nëpërmjet 3895 vlerësimeve të nxënësve nga klasa e dytë dhe e tretë të realizuar në 42 shkolla fillore.

Më shumë informata për procesin e përshtatjes së instrumenteve EGRA dhe EGMA dhe realizimit të tyre në shkolla për matjen e arritjeve të nxënësve në lexim dhe matematikë në fund të klasës së dytë dhe të tretë mund të gjeni në raportin për vlerësimin e gjendjes fillestare, që mund ta lexoni në gjuhë maqedonase dhe angleze në faqen http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/RAL_Baseline_report_September_2014.pdf dhe raportin nga studimi i realizuar në maj të vitit 2015, që mund ta lexoni në gjuhë maqedonase, shqipe dhe angleze në http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Izveshtaj_od_studijata_za_EGRA_i_EGMA_-_maj_2015.pdf

Qëllimet e studimit të parë nacional me instrumentet EGRA dhe EGMA të realizuar në maj të vitit 2016 ishin të dyfishta:

¹ EGRA është shkurtesë nga emri i instrumentit në gjuhë angleze – Early Grade Reading Assessment, derisa EGMA është shkurtesë nga Early Grade Mathematics Assessment

1. Të mblidhen të dhëna për arritjet në lexim dhe matematikë në mostër prej 4000 nxënësve nga klasa e dytë dhe 4000 nxënësve nga klasa e tretë nga 336 shkolla fillore të cilat ndjekin mësim në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke;
2. Të mblidhen të dhëna për avancimin në lexim dhe matematikë të nxënësve nga klasa e katërt, të cilët për herë të parë me EGRA dhe EGMA qenë vlerësuar në maj të vitit 2014. Vlerësimi longitudinal i këtyre nxënësve që realizuar katër vite një pas një (nga viti 2014 e deri në vitin 2017), dhe do të na ndihmon t'i ndjekim arritjet e tyre nga klasa e dytë e deri në klasën e pestë.

Rezultatet nacionale për nxënësit e klasës së dytë dhe klasës së tretë, si edhe rezultatet longitudinale të nxënësve nga klasa e katërt dhe klasa e pestë do të na ndihmojnë të përcaktojmë standarde për arritje në lexim dhe në matematikë për nxënësit e klasave fillestare.

1.1 Popullata dhe mostra

Popullata për studimin e parë nacional të realizuar me instrumentet EGRA dhe EGMA ishin përkufizuar si: të gjithë nxënësit nga klasa e dytë dhe e tretë me mësim në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke.

Që të zgjidhet mostra nga popullata që u definua më lartë së pari ishin mbledhur të dhëna për të gjithë klasat dhe nxënësit nga klasa e dytë dhe klasa e tretë me mësim në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke. Sipas të dhënave të dorëzuara popullata që formuar nga 20704 nxënës të klasës së dytë dhe 20341 nxënës të klasës së tretë.

Secilës shkollë nga baza e të dhënave iu dha një shifër unike e cila përmbante të dhëna për rajonin të cilit i përket (i Shkupit, veri-lindor, i Vardarit, lindor, jug-lindor, jug- perëndimor, i Pellagonisë dhe i Pollogut). Secilit iu dha shifër unike e përbërë nga: numri unik i shkollës, gjuha në të cilën do të bëhet vlerësimi (maqedonase, shqipe ose turke), shenjë për klasën (numri rendor i paraleles në shkollë) dhe shenjë për nxënësin (numri rendor i nxënësit në ditar).

Që në fillim ishte përcaktuar se do të vlerësohen gjithsej 8000 nxënës (4000 nga klasa e dytë dhe 4000 nga klasa e tretë). Të gjithë shkollat qenë ndarë në tre lista në bazë të tri shtresa eksplicite sipas gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi (në gjuhën maqedonase, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke). Shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në dy ose tre gjuhë mësimore llogariteshin si shkolla të ndara. Që mostra e nxënësve sa më mirë t'i reflektojë karakteristikat e shkollave, së pari ishte përcaktuar raporti mes nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke. Pastaj shkollat nga secila listë në bazë të numrit të nxënësve në klasën e dytë gjegjësisht në klasën e tretë ishin ndarë në të vogla, të mesme dhe të mëdha dhe që llogaritur nga sa nxënës të secilit grup duhet të zgjidhen.

Zgjedhja e nxënësve në kuadër të një shkolle u bë sipas zgjedhjes së rastit në bazë të listave të dorëzuara.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të zgjedhur në mostër (4017 për klasën e dytë dhe 4171 për klasën e tretë), vlerësimet u realizuan te 3768 nxënës nga klasa e dytë dhe 3818 nxënës nga klasa e tretë. Rënia për klasën e dytë ishte 6.2%, derisa në klasën e tretë 8.5%. Arsyeja kryesore për rënien është mungesa më e gjatë e nxënësve për shkak të sëmundjes ose emigrimit të familjes së nxënësit në vend të huaj.

Në mënyrë shtuese, ishin mbledhur të dhëna nga mostra longitudinale e nxënësve nga klasa e katërt nga 42 shkolla të cilët morën pjesë në aktivitetet projektuese që nga fillimi. Këto nxënës qenë pjesë e mostrës për të cilën u mbledhën të dhëna për gjendjen fillestare në shkrim lexim në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore në kuadër të studimit të realizuar në vitin 2014, kur ata ishin klasa e dytë dhe përsëri qenë vlerësuar në vitin 2015 kur ishin klasa e tretë.

Tabela 1. Numri i nxënësve të vlerësuar në mostrën nacionale dhe në atë longitudinale sipas klasave, gjinisë dhe gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi

Klasa Gjuha mësimore Gjinia	E dytë (fillestare)		E tretë (fillestare)		E katërt (longitudinale)	
	M	F	M	F	M	F
Maqedonisht	1,258	1,184	1,265	1,183	185	187
Shqip	602	571	660	550	61	73
Turqisht	63	90	80	80		
Gjithsej	1,923	1,845	2,005	1,813	246	260
GJITHSEJ	3,768		3,818		506	

1.2 Struktura e instrumenteve

Instrumenti për vlerësimin e shkrim leximit në fushë të gjuhës (EGRA) është i njëjtë si për klasën e dytë ashtu edhe për klasën e tretë, i përshtatur në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke dhe përbëhet nga këto komponentë:

- Detyra 1 – Njohja e shkronjave dhe shqiptimi i tyre (100 kombinime të shkronjave)
- Detyra 2 – Shpejtësia e leximit të fjalëve të njohura (50 fjalë)
- Detyra 3 dhe 5 – Shpejtësia e të lexuarit të tekstit logjik (tregim nga rreth 100 deri në 200 fjalë)
- Detyra 4 dhe 6 – Të kuptuarit e asaj që është lexuar (kontrollohet nëpërmjet mbi 10 pyetjeve për secilin tekst)

Detyrat nga instrumenti EGRA janë treguar në Shtojcën 1.

Zgjidhja e të gjitha detyrave në EGRA është e kufizuar në një minutë. Matja e kohës është shumë e rëndësishme në zgjedhjen e detyrave të EGRA-së, sepse nxënësit në atë mënyrë fitojnë automatizëm në lexim, gjegjësisht zhvillojnë aftësi për lexim të shpejtë, i cili do t'ju mundësojë të lexojnë tekste më të gjatë dhe të përqendrohen në domethënien të asaj që është lexuar. "Automatizmi" në realitet do me thënë njohje e shpejtë e fjalëve, ashtu që lexuesi nuk bën përpjekje të mëdha mentale, ose nuk është i vetëdijshëm për atë, kur i transformon shkronjat në zëra dhe nga ata bën fjalë. Në këtë nivel, lexuesi shpejtë i dekodon shkronjat dhe është në gjendje të përqendrohet në kuptimin të asaj që ka lexuar.

Instrumenti për vlerësimin e njohurive themelore matematikore (EGMA) përbëhet nga këto komponentë:

- Detyra 1 – Krahasimi i numrave
- Detyra 2 – Vazhdo vargun (numri që mungon në varg)
- Detyra 3 – Mbledhja
- Detyra 4 – Zbritja

- Detyra 5 – Detyra tekstuale
- Detyra 6 – Njohja e formave gjeometrike
- Detyra 7 – Vazhdimi i vargut me forma gjeometrike (forma e cila mungon në varg)

Detyrat nga instrumenti EGMA janë treguar në Shtojcën 2.

Për zgjedhjen e detyrave për mbledhje, zbritje dhe detyrat tekstuale, nxënësit kanë në dispozicion materiale didaktike, laps dhe letër që ta kryejnë llogaritjen e duhur. Gjithashtu, u qe lejuar t'i përdorin edhe gishtërinjtë. Pas secilës detyrë, në bazë të vrojtimit, vlerësuesi vërente cilën strategji për llogaritje e ka përdorur nxënësi (p.sh. numërim me gishtërinj, përdorimi i materialeve didaktike, shënimi ose llogaritja përmendsh).

Për secilën detyrë në EGMA dhe EGMA në fillim qenë dhënë disa shembuj, që nxënësit të mund të kuptojnë çka kërkohet nga ata, kurse vlerësuesi t'u jep informatë kthyesë për atë se a e zgjidhin detyrën ashtu si duhet.

Që të zvogëlohet koha e nevojshme për zgjidhjen e detyrave, por edhe fëmijët të lirohen nga stresi të cilin mund ta përjetojnë në përpjekjet e pasuksesshme të zgjidhin një detyrë në një interval kohor më të gjatë, detyrat në EGMA qenë kufizuar në kohëzgjatje prej dy minutave. Në mënyrë shtesë, për t'ju shmangur lodhjes dhe frikës të fëmijët dhe që të kuptojmë sa më shumë për aftësitë e tyre për zgjidhje të secilës detyrë, që futur rregulla universale për ndërprerje të testit. Kjo rregull zbatohet te të gjitha detyrat. Rregulla thotë: nëse fëmija i gabon katër ajtëmet e parë një nga detyra, vlerësuesi duhet ta ndërpresë nxënësin dhe të vazhdojë me detyrën vijuese. Megjithatë, fëmijës duhet t'i lihet mundësia që të përpiqet ta zgjidh çdo detyrë.

Para fillimit të vlerësimit me EGMA, vlerësuesi plotëson të dhëna për shkollën në të cilën nxënësi e ndjek mësimin. Gjithashtu nxënësve u qenë parashtruar disa pyetje të përgjithshme që të marrin informata rreth shprehive të tyre e që kanë lidhje me shkrim leximin në fushë të gjuhës dhe njohurive themelore matematikore:

- Lloji i shkollës në të cilën nxënësi e ndjek mësimin (shkollë qendrore ose shkollë periferike);
- Lloji i paraleles (e pastër ose e kombinuar);
- Klasa e nxënësit (e dyta apo e treta);
- Gjinia (mashkullore, femërore);
- Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi (maqedonisht, shqip, turqisht);
- Arsimi i nënës/kujdestares (fillore ose më pak, e mesme, e lartë ose më shumë);
- Arsimi i babait/kujdestarit (fillor ose më pak, i mesëm, i lartë ose më shumë);
- Moshë;
- Gjuha e cila flitet në shtëpi (maqedonisht, shqip, turqisht, gjuha rome, serbisht ose ndonjë gjuhë tjetër). Te kjo pyetje mund të evidentohen dy ose më shumë përgjigje, nëse nxënësit kanë prejardhje nga një familje më shumë gjuhësh;
- A kanë ndjekur institucion parashkollor;
- Në shtëpi a kanë qasje deri te librat;
- A kanë lexuar para se të vijnë në shkollë;
- A huazojnë libra nga biblioteka;
- A kanë shprehur të lexojnë vet ose me dikë nga anëtarët e familjes (nëna, babai, të dy prindërit, vëllezërit ose motrat, gjyshi ose gjyshja, ose më dikë tjetër).

Kjo pjesë e instrumentit përdoret edhe për t'u filluar biseda me nxënësin dhe të vendoset kontakt me atë, që është një çast shumë i rëndësishëm të vlerësimit gojor individual.

1.3 Trajnimi për parashtrimin e detyrave të instrumenteve EGRA dhe EGMA

Vlerësuesit që janë përgjegjës për parashtrimin e instrumenteve EGRA dhe EGMA në shkollë kanë ndikim të rëndësishëm mbi kualitetin e rezultateve të fituara, prandaj ato ndoqën një trajnim përkatës. Për shkak se mbledhja e të dhënave zhvillohej në rrugë elektronike, me ndihmën e tabletë kompjuterit, një pjesë e trajnimit përfshinte edhe zbatim praktik për parashtrimin të instrumenteve me tabletë kompjuter. Në trajnim morën pjesë përfaqësues të shërbimit profesional (pedagog ose psikolog) ose mësimdhënës i grupit klasor. Vlerësuesit qenë trajnuar në gjuhën në të cilën e parashtron instrumentin – maqedonisht, shqip ose turqisht. Gjithsej qenë trajnuar 750 vlerësues nga të gjithë shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë.

1.4 Mbledhja e të dhënave, përpunimi, analiza dhe raportimi

Duke e pasur parasysh numrin e madh të vlerësuesve dhe pjesëmarrjes të të gjithë shkollave fillore, si dhe periudhën në të cilën u parashtruan instrumentet kohë e cila zakonisht është e mbushur me shumë aktivitetet në shkollë, vlerësimet me EGRA dhe EGMA u realizuan 3 javë në periudhën nga 9 deri më 31 maj të vitit 2016.

Instrumentet qenë parashtruar në 336 shkolla ose, veç e veç sipas gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, në 265 shkolla me mësim në gjuhën maqedonase, 134 shkolla me mësim në gjuhën shqipe dhe 39 shkolla me mësim në gjuhën turke.

Siç u përmend më lartë, në tërë këtë proces shumë është e rëndësishme të sigurohen të dhëna kualitative, të vlefshme dhe të besueshme. Për atë qëllim qenë angazhuar 71 vrojtues, mes të cilëve këshilltar të QSHP-së, profesor nga fakultetet pedagogjike, praktikant nga grupi punues të cilët morën pjesë në zhvillimin e instrumenteve dhe edukator nga Fondacioni “Hap pas hapi”, të cilët e ndoqën procesin e realizimit të vlerësimit.

Të dhënat e mbledhura qenë përpunuar nga ana e Beti Llamevës, udhëheqës i departamentit për maturë shtetërore dhe IT nga Qendra Shtetërore e Provimeve.


Në analizën e raportit me rezultate nga EGRA dhe EGMA janë treguar arritjet e nxënësve në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë, gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, vendndodhjes së shkollë dhe shkallës së arsimit të prindërve.

2. REZULTATE NACIONALE NGA VLERËSIMI I GJENDJES FILLESTARE NË SHKRIM LEXIM NË FUSHË TË GJUHËS DHE NJOHURITË THEMELORE MATEMATIKORE

Në këtë pjesë bëjmë rezyme të rezultateve statistike për të gjitha detyrat nga studimi nacional në EGRA dhe EGMA të realizuar në Maqedoni në 336 shkolla fillore.

2.1 Karakteristikat e mostrës

Rreth 65% nga nxënësit të mostrës kanë ndjekur mësim në gjuhën maqedonase, 31% në gjuhë shqipe dhe 4% në gjuhë turke. Pjesa më e madhe e nxënësve (64%) kanë qenë nga qendra urbane, kurse 36% nga qendra rurale. Mostra në përqindje kanë qenë e përbërë nga 52% meshkuj dhe 48% femra).




Grafiku 1. Përqindja e nxënësve në mostrën për EGRA sipas: klasës, gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, vendndodhja e shkollë dhe gjinia

2.2 Sa lexojnë mirë nxënësit në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke?


Përqindja mesatare e zgjidhjes së instrumentit EGRA bazohet mbi P-vlerën mesatare që fitohet kur rezultati mesatar i arritur në test do të pjesëtohet me rezultatin e mundshëm maksimal dhe kjo shumëzohet me 100.

Krahasimi i rezultateve nga EGRA në të tri gjuhët në të cilët zhvillohet mësimi në klasën e dytë tregon se nxënësit kanë rezultate më të mira në detyrën njohja e shkronjave dhe shqiptimi i tyre (përqindja mesatare e zgjidhjes është 75.6% te nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase, 79.6% te nxënësit me mësim në gjuhë shqipe dhe 73.7% te nxënësit me mësim në gjuhë turke), derisa rezultatet më të këqija janë të arritur në detyrën për kuptim të asaj që është lexuar (39.6% te nxënësit me mësim në gjuhë maqedonase, 36.4% nxënës me mësim në gjuhë shqipe dhe 21.2 % te nxënësit me mësim në gjuhën turke).



Grafiku 2. Përqindja mesatare e zgjidhjes së detyrave në EGRA për klasë të dytë

Në klasën e tretë siç pritej, nxënësit kanë rezultate më të mira në të gjitha gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi, por përsëri rezultate më të mira arrihen në njohjen e shkronjave dhe shqiptimin e tyre (përqindja mesatare e zgjidhjes është 83.6% te nxënësit me mësim në gjuhë maqedonishte, 87.4% te nxënësit me mësim në gjuhën shqipe dhe 86.7% te nxënësit me mësim në gjuhën turke), pas së cilës vijojnë rezultatet e detyrës lexim i fjalëve të njohura dhe leximi i rrjedhshëm, kurse rezultate më të këqija ka në të kuptuarit e tekstit të lexuar (59% te nxënësit me mësim në gjuhë maqedonase, 53% te nxënësit me mësim në gjuhë shqipe dhe 38% te nxënësit me mësim në gjuhën turke).



Grafiku 3. Përqindja mesatare e zgjidhjes së detyrave në EGRA për klasën e tretë

Nëse shihen rezultatet sipas detyrave në EGRA (shih Tabelën 2) do të shihet se nxënësit kanë arritje të mira në njohjen e shkronjave në të dy klasat në të tri gjuhët në të cilën zhvillohet mësimi. Numri i shkronjave të lexuara saktë në një minutë ndryshon nga 77 te nxënësit me mësim në gjuhën turke në klasën e dytë, deri në 96 te nxënësit me mësim në gjuhën shqipe në klasën e tretë.

Në detyrën leximi i fjalëve të njohura, nxënësit e klasës së dytë arrijnë rezultat nga 31 deri në 37 fjalë të lexuar saktë në një minutë, derisa në klasën e tretë nga 51 deri në 55 fjalë të lexuar saktë në një minutë.

Detyra për lexim të rrjedhshëm tregon se arritjet e nxënësve ndryshojnë në varësi nga gjuha në të cilën zhvillohet mësimi. Nxënësit nga klasa e dytë lexojnë deri në 27 fjalë të lexuar saktë në një minutë te nxënësit me mësim në gjuhën turke, 44 te nxënësit maqedonas deri në 47 te nxënësit me mësim në gjuhën shqipe. Në klasën e tretë, nxënësit lexojnë nga 47 fjalë të lexuar saktë në një minutë te nxënësit me mësim në gjuhën turke, 68 te nxënësit maqedonas deri në 70 te nxënësit që mësojnë në gjuhën shqipe. Këto rezultate janë shqetësuese, sepse me qëllim që nxënësit të kuptojnë 80% të tekstit të lexuar (që është standard i pranuar ndërkombëtarisht për kuptimin e asaj që është lexuar), rrjedhshmëria gjatë të lexuarit duhet të jetë mes 50 dhe 80 fjalë të lexuar saktë në një minutë². Kur rrjedhshmëria gjatë të lexuarit do të ishte në këtë nivel do me thënë se nxënësit lexojnë mjaft shpejtë që të mundën ta mbajnë tekstin aq gjatë në memorien e tyre punuese që të mundet ta kuptojnë (rreth 60 fjalë të lexuar saktë në një minutë për tekste më të thjeshta dhe më shumë për tekste më të komplikuar).

Tabela 2. Rezultate mesatare të nxënësve në detyrat EGRA dhe EGMA sipas klasëve dhe gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi

Klasa	E dytë (gjendja fillestare)			E tretë (gjendja fillestare)		
	maq.	shqip.	tur.	maq.	shqip.	tur.
Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi Numri gjithsej	2.442	1.173	153	2.448	1.210	160
Shkronja të lexuara saktë në min.	78	84	77	88	96	95
Fjalë të lexuara saktë në min.	34	37	31	51	55	54
Fjalë të lexuara saktë në tregim për një minutë	44	47	27	68	70	47
Standard për të lexuarit e rrjedhshëm në SHBA	(47 - 53)			(72 - 89)		
Të kuptuarit e asaj që është lexuar	40%	35%	20%	60%	55%	40%
Standard ndërkombëtar	80%			80%		

Rezultati mesatar i të kuptuarit të asaj që është lexuar në klasën e dytë lëviz nga 20% te nxënësit me mësim në gjuhën turke, 35% te nxënësit me mësim në gjuhën shqipe deri në 40% te nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase. Në klasën e tretë, lëviz prej 40% te nxënësit me mësim në gjuhën turke, 55% te nxënësit me mësim në gjuhën shqipe deri më

² RTI (2010). "Early Literacy: Igniting education for all". RTI Publication.

60% te nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase. Rezultatet tregojnë se nxënësit në Maqedoni as përafërsisht nuk e arrijnë standardin ndërkombëtar të përgjigjen në 80% të pyetjeve as në klasën e dytë e as në klasën e tretë që është shumë brengosëse.

Analiza shtesë tregoi se ekziston korrelacion pozitiv mes rrjedhshmërisë gjatë leximit dhe kuptimit të së lexuarës që nga aspekti statistikë është e rëndësishme në të tri gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi në të dy klasat, që do të thotë se rritja e rrjedhshmërisë gjatë të lexuarit do ta rrisë edhe të kuptuarit.

Disa metoda statistikore (Hi katror, t-test dhe analiza e variantit) qenë përdorur që në mënyrë shtesë të hulumtohet si ndryshoret vijuese janë të lidhura me rezultatet për rrjedhshmërinë gjatë të lexuarit dhe të kuptuarit të asaj që është lexuar:

- Lloj i shkollës (qendrore ose periferike);
- Lloj i klasës (e pastër ose e kombinuar);
- Ndjekja e institucioneve parashkollore;
- Mundësia e qasjes deri te librat në shtëpi;
- Aftësia për të lexuar para se të fillojë shkollimin;
- Huazimi i librave nga biblioteka;
- Gjinia;
- Arsimi i prindërve.

Rezultate tregojnë se ekziston dallim i rëndësishëm statistikor mes rrjedhshmërisë gjatë leximi në të dy klasat, në të gjithë gjuhët mësimore, sipas arsimit të të dy prindërve, gjegjësisht fëmijët e atyre prindërve të cilët kanë arsim më të lartë lexojnë më rrjedhshëm dhe më shumë e kuptojnë tekstin e lexuar.

Nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase kanë arritje më të mëdha nëse kanë ditur të lexojnë para se të fillojnë të shkojnë në shkollë (klasa e dytë) ose nëse e ndjekin mësim në paralele të pastra në shkollë qendrore dhe nëse huazojnë libra nga biblioteka (klasa e tretë).

Nxënësit nga klasat me mësim në gjuhën shqipe, mund të lexojnë më shumë fjalë saktësisht në një minutë nëse kanë ndjekur paralele të kombinuara dhe kanë huazuar libra nga biblioteka (klasa e dytë) ose kanë ndjekur institucion parashkollor (klasa e tretë).

Nxënësit nga klasat me mësim në gjuhë turke, të mësuarit në shkollë qendrore, njohja e leximit para nisjes së shkollimit dhe huazimi i librave nga biblioteka në mënyrë të konsiderueshme e kanë rritur rrjedhshmërinë gjatë leximit në klasën e dytë, në klasën e tretë ka ndikuar posedimi i librave të tjerë në shtëpi.

Për sa i përket kuptimit të asaj që është lexuar, nxënësit me mësim në gjuhë maqedonase në të dy klasat të cilët kanë ndjekur institucion parashkollor, kanë libra të tjerë në shtëpi dhe kanë huazuar libra nga biblioteka kanë pasur rezultate konsiderueshëm më të mira në kuptimin e tekstit.

Nxënësit me mësim në gjuhë shqipe të cilët nuk e kanë ndjekur institucione parashkollore, nuk kanë ditur të lexojnë para se të fillojnë shkollimin, nuk kanë libra të tjerë në shtëpi dhe nuk kanë huazuar libra nga biblioteka, kanë pasur rezultate konsiderueshëm më të ulëta gjatë kuptimit të asaj që është lexuar në të dy klasat.


Nxënësit me mësim në gjuhë turke të klasës së dytë që nuk kanë pasur libra të tjerë në shtëpi kanë pasur rezultate konsiderueshëm më të dobëta në kuptimin e asaj që është

lexuar, derisa te nxënësit e klasës së tretë rezultate konsiderueshëm më të mira kanë pasur ata që kanë libra të tjerë në shtëpi.

Me zbatim të analizës regressive u tregua se faktorë më të rëndësishëm që janë të lidhur me zhvillimin e rrjedhshmërisë gjatë leximit dhe kuptimit të asaj që është lexuar janë shkathtësitë e zhvilluara për lexim para se të fillohet shkollimi dhe posedimi i librave të tjerë në shtëpi. Librat që fëmijët i kanë në shtëpi gjithashtu ndikojnë mbi kuptimin më të mirë të asaj që është lexuar.

2.3 Sa i zhvillojnë mirë nxënësit shkathtësitë themelore matematikore?

Në përgjithësi sipas përqindjes së zgjidhjes së detyrave në EGMA, krahasimi i numrave dhe vargjet me forma gjeometrike janë detyra më të lehta (i kanë zgjidhur mbi 90% e nxënësve). Detyrë më e vështirë në të dy klasat është zbritja (përqindja mesatare e zgjidhjes është 54% në klasën e dytë dhe 57% në klasën e tretë) pas së cilës vijojnë detyrat tekstuale (rreth 66% në të dy klasat).



Grafiku 4. Përqindja mesatare e zgjidhjes së detyrave në EGMA

Nëse shihen rezultatet sipas detyrave në EGMA (shih Tabelën 3) detyra krahasimi i numrave është detyrë më e lehtë për nxënësit e të dy klasave sepse pjesa më e madhe e tyre e zgjedhin.

Në detyrën ku duhet të tregohet cili numër mungon në vargun e numrave, nxënësit e klasës së dytë saktë i zgjidhin 4 deri në 5 detyra, derisa nxënësit e klasës së tretë 5 deri në 7 detyra.

Në detyrat për mbledhje dhe zbritje, ku vlerësohet kompetenca procedurale e nxënësve gjatë operacioneve themelore matematikore, rezultatet janë shumë më të ulëta.

Nxënësit e klasës së dytë mund të mbledhin saktë katër deri në dhjetë detyra, derisa në të klasës së tretë pesë deri në dhjetë detyra. Te zbritja, nxënësit e klasës së dytë saktë mund të zgjidhin tre detyra derisa nxënësit e klasës së tretë katër nga gjithsej dhjetë detyra.

Te detyrat tekstuale, nxënësit e të dy klasave mund të zgjidhin mes dy dhe tre detyra nga gjithsej dhjetë detyra.

Gjatë zgjidhjes së detyrave nga tri fushat e lartpërmendura, nxënësit më së shumti llogarisin përmendsh. Një e treta e nxënësve të klasës së dytë dhe një e katërta e nxënësve të klasës së tretë i përdorin gishtërinjtë. Nxënësit e klasës së dytë më pak përdorin lapsin dhe letrën, kurse ato të klasës së tretë mjetet didaktike.

Në fushën e gjeometrisë, nxënësit kanë rezultate të mira në njohjen e formave gjeometrike dhe në vazhdimin e vargut të formave gjeometrike.

Tabela 3. Rezultatet mesatare të nxënësve në detyrat EGMA sipas klasave


Klasa	E dytë	E tretë
Numri gjithsej i nxënësve të vlerësuar	3792	3858
1. Krahasimi i numrave		
Numri i ajteve në detyrë	7	10
Detyra të zgjidhura saktë në minutë	23	20
2. Numri që mungon në varg		
Numri i ajteve në detyrë	5	7
Detyra të zgjidhura saktë	3.63	5.07
3. Mbledhja		
Numri i ajteve në detyrë	10	10
Detyra të zgjidhura saktë në minutë	4.25	5
4. Zbritja		
Numri i ajteve në detyrë	10	10
Detyra të zgjidhura saktë në minutë	3	4
5. Detyra tekstuale		
Numri i ajteve në detyrë	4	4
Detyra të zgjidhura saktë	2.65	2.63
6. Njohja e formave gjeometrike		
Numri i ajteve në detyrë	3	3
Detyra të zgjidhura saktë	2.74	2.48
7. Vargu me forma gjeometrike		
Numri i ajteve në detyrë	3	3
Detyra të zgjidhura saktë	2.64	2,48

Faktorë kryesor për arritje më të mira në matematikë janë:


- Arsim më i lartë i prindërve
- Ndjekja e mësimin në shkolla qendrore ose periferike dhe paralele që nuk janë të kombinuara
- Ndjekja e institucionit parashkollor
- Posedimi i librave në shtëpi

3. REZULTATE LONGITUDINALE NGA EGRA DHE EGMA

Nga aspekti longitudinal, rezultatet mesatare të nxënësve me mësim në gjuhë maqedonase dhe gjuhë shqipe në instrumentin EGRAJ rriten me rritjen e klasës. Por, përsëri rezultate më të mira janë në njohjen e shkronjave, kurse rezultate më të dobëta në kuptimin e asaj që është lexuar.



Grafiku 5. Krahasimi sipas klasave të përqindjes mesatare të zgjidhjes së detyrave në EGRA në klasat me mësim në gjuhë maqedonase



Grafiku 6. Krahasimi sipas klasave të përqindjes mesatare të zgjidhjes së detyrave në EGRA në klasat me mësim në gjuhë shqipe

Krahasimi i rezultateve sipas detyrave (shih Tabelën 4) tregojnë se nxënësit e klasës së katërt lexojnë më rrjedhshëm në raport me kohën kur kanë qenë klasa e dytë, gjatë së cilës vërehet avancimi nga 41 fjalë të lexuara saktë në një minutë në klasën e dytë në 94 fjalë të lexuara saktë në një minutë në klasën e katërt të nxënësit me mësim në gjuhë maqedonase dhe nga 40 fjalë të lexuara saktë në një minutë në klasën e dytë në 89 fjalë të lexuara saktë në një minutë në klasën e katërt të nxënësit me mësim në gjuhë shqipe.

Tabela 4. Avancimi i nxënësve nga mostra longitudinal në lexim sipas klasave


Klasa	E dytë (2014)		E tretë (2015)		E katërt (2016)	
	maq.	shqip	maq.	shqip	maq.	shqip
Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi Numri gjithsej	731	250	692	229	372	136
Shkronja të lexuara saktë në minutë	74	83	87	108	104	106
Fjalë të lexuara saktë në minutë	31	30	49	53	69	68
Fjalë të lexuara saktë në minutë në tregim	41	40	81	77	94	89
Standard për lexim të rrjedhshëm në SHBA	(47 - 53)		(72 - 89)		(92 - 107)	
Të kuptuarit e asaj që është lexuar	46%	37%	69%	58%	75%	62%
Standardi ndërkombëtar	80%					

Të kuptuarit e asaj që është lexuar është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga 46% në klasën e dytë në 75% në klasën e katërt të nxënësit me mësim në gjuhë maqedonase dhe nga 37% në klasën e dytë në 62% në klasë të katërt të nxënësit me mësim në gjuhë shqipe. Megjithatë, edhe këto rezultate ende janë nën standardin ndërkombëtar prej 80%.

Në matematikë, nxënësit e klasës së katërt avancim më të madh kanë gjatë zgjidhjes së detyrave tekstuale (54% në klasën e tretë, 76% në klasën e katërt) dhe në njohjen e formave gjeometrike (72% në klasën e tretë, 95% në klasën e katërt). Nga ana tjetër, rezultate janë keqësuar në mbledhje (87% në klasën e tretë, 84% në klasën e katërt) dhe në zbritje (72% nënklasën e tretë, 71% në klasën e katërt).

Sipas strategjisë për llogaritje që e përdorin në klasën e katërt, dominuese është llogaritje përmendësh dhe përdorimi i lapsit dhe letrës.

Edhe në të dy fushat e gjeometrisë, njohja e formave gjeometrike dhe vazhdimi i vargut të formave gjeometrike, rezultatet e nxënësve janë të larta.



Grafiku 7. Krahasimi sipas klasave të përqindjes mesatare të zgjidhjes së detyrave në EGMA

4. ÇKA MËSUAM NGA REALIZIMI I EGRA-SË DHE EGMA-SË

Rezultatet nacionale nga vlerësimi i gjendjes fillestare me shkrim leximin në fushë të gjuhës i vërtetojnë rezultate nga studimet të realizuara në kuadër të projektit në vitet e kaluara të cilët tregojnë se shkathtësitë të njohjes së shkronjave janë të zhvilluara mirë te nxënësit e klasës së dytë dhe klasës së tretë, derisa leximi i rrjedhshëm dhe kuptimi i tekstit të lexuar ngel grykë e ngushtë në klasat fillestare të sistemit tonë arsimor.

Pjesa më e madhe e gjetjeve të studimit tonë janë vërtetim i literaturës hulumtuese dhe teorisë në këtë fushë. Mirëpo, analiza e faktorëve që janë të lidhur me rrjedhshmërinë gjatë leximit dhe kuptimin e asaj që është lexuar nuk tregon një lidhje lineare me të gjithë ndryshoret për të dy klasat dhe të tri gjuhët në të cilët zhvillohet mësimi.

Rezultatet nën mesatarja në rrjedhshmërinë gjatë leximit dhe kuptimin e asaj që është lexuar, veçanërisht në fund të klasës së tretë, ndoshta janë rezultat i disa faktorëve për shkak të së cilëve nxënësit nuk i përvetësojnë këto shkathtësi të rëndësishme të leximit:

- Resurse të pamjaftueshme në shkolla dhe në shtëpitë e nxënësve,
- Kohë e pamjaftueshme për të mësuar (për shembull gjatë apo pas mësimi),
- Mësimdhënësit/drejtorët kanë stimulim të vogël që ta përmirësojnë mësimdhënien,
- Plan programe mësimore të cilat nuk përkrijnë me stilet e të nxënësve të nxënësve,
- Mësimdhënien nuk është e individualizuar sipas aftësive, arritjeve dhe nevojave të nxënësve,

- Mos pasje të mësimit shtesë për nxënësit me arritje më të dobëta³.

Për sa i përket rezultateve nga matematika, duke pasur parasysh se programi i ri mësimor në matematikë dhe shkenca natyrore në shkollat në Maqedoni u fut në shtator të vitit 2014, nevojitet kohë më e madhe që mësimdhënësit në tërësi ta përvetësojnë, që të mundet nga arritjet e nxënësve të përfundohet ky ndryshim a ka sjellë deri te rezultate më të mira.

Rezultatet më të dobëta gjatë zgjidhjes mesatare të detyrave në fushën e mbledhjes dhe zbritjes të nxënësit e klasës së katërt nga mostra longitudinale, janë shenjë brengosëse se këta nxënës kanë kaluar në mësimin e koncepteve matematikore më të ndërlikuara para se t'i përvetësojnë operacionet themelore. Përndryshe, gjatë vlerësimit të parë me EGRA dhe EGMA në maj të vitit 2014, këta nxënës ishin klasa e dytë dhe mësonin matematikë sipas programit të vjetër ku mbledhja dhe zbritja mësoheshin deri në 20. Në vitin e ardhshëm mësimor 2014/2015 kur u fut programi i ri mësimor, këto nxënës ishin klasa e tretë dhe mësonin mbledhje dhe zbritje deri në 1000, me çka "e kapërcyen" nivelin e mbledhjes dhe zbritjes deri në 100, që ndoshta është një nga faktorët që ndikuan në keqësimin e arritjeve të tyre në këtë fushë.

Llogaritja përmendësh është strategji dominuese që e përdorin nxënësit në të gjitha klasat, para përdorimit të gishtërinjve, lapsit dhe letrës ose mjeteve didaktike. Edhe pse në disa shkolla fillore përdoren mjete didaktike, përdorimi i tyre nuk është e përhapur as efektive aq sa duhet. Sipas psikologut zviceran Zhan Pijazhe⁴ fëmijët e moshës prej shtatë deri në dhjetë vjeçare punojnë me operacione konkrete dhe konceptet matematikore abstrakte mund t'i kuptojnë vetëm kur përdorin materiale konkrete. Prandaj përdorimi i mjeteve didaktike duhet të jetë bazë për zhvillimin e ideve matematikore në klasat fillestare veçanërisht te fëmijët e moshave nën 11 vjeçare.

5. REKOMANDIME TË RËNDËSISHME PËR NË TË ARDHMEN

Rezultatet e fituara nga zbatimi i EGRA-së dhe EGMA-së tregojnë për disa fusha të rëndësishme të veçantë në të cilat janë të nevojshme intervenime:

Në nivel të shkollës:

- Të përshtatet **orari** që nxënësit të kenë mundësi të kalojnë pjesë më të madhe të mësimit në **lexim të përbashkët dhe të pavarur**;
- Të krijohen **kënde të leximit** ose **biblioteka të vogla në klasë** që nxënësit të kenë materiale të mjaftueshme për ushtrimin e leximit;
- **Orët të përshtaten** sipas nevojave dhe rezultateve të nxënësve;
- Është e nevojshme që në moshën e hershme nxënësve t'u parashtrohen **lloje të ndryshme të pyetjeve** që të munden ta shprehin mendimin e tyre, t'i interpretojnë faktet ose të sjellin gjykimin tyre që t'u zmadhohet niveli i kuptimit;
- Të organizohen **punëtori me prindërit** dhe anëtarët tjerë të familjes dhe të shkëmbehen ide dhe këshilla për angazhimin e fëmijëve në aktivitete të ndryshme për nxitjen e përvetësimit të shkrimit leximit. Kjo veçanërisht është e rëndësishme në mjedise ku nuk ka institucione parashkollore, ku arsimiti i prindërve është në nivel më të ulët dhe ku nuk ka mbështetje të mjaftueshme nga bashkësia;

³ Floretta, J., Neal, M. & Strathmann, L. (2016) Moving Beyond Inputs: Lessons from Models to Improve Early Grade Reading Outcomes in Developing Countries, Presentation for EGRA webinar, Cambridge: J-Pal and Massachusetts Institute of Technology.

⁴ Piaget, J. (1952). *The child's concept of number*. New York: Humanities Press.

- Të ripërtërihen **bibliotekat shkollore** dhe të sigurohen **më shumë resurse** për nxënësit e klasave fillestare. Biblioteka të jetë vend i këndshëm dhe komfort ku do të mund të kënaqen gjatë leximit;
- Mësimdhënësi ta ndjek **avancimin në lexim** në klasë disa herë në vit që herët të detektojë nxënësit që kanë vështirësi në lexim dhe t'u sigurohet **mbështetje përkatëse dhe mësim shtesë**;
- Të organizohen trajnime praktike për mësimdhënësit sepse ata më së miri mësojnë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe ndërveprimit me mësimdhënësit të tjerë (punëtori të shkurta të plotësuar me vizita mentoriale në shkollë);
- Të sigurohet zhvillim i rregullt profesional për mësimdhënësit dhe shërbimin profesional nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera sepse ende u nevojitet mbështetja dhe praktika për realizimin e përmbajtjeve të caktuara mësimore.

Pjesë e rekomandimeve të cilat mësimdhënësit duhet t'i kenë parasysh për sa i përket leximit dhe matematikës janë:

- Nxënësve duhet t'u lejohet të lexojnë sipas tempos së tyre, edhe nëse ajo do të thotë se ata që lexojnë më ngadalë do të ngecin pas atyre që lexojnë më shpejtë. Leximi i shpejtë, vetëm që të lexohet teksti, i pengon nxënësit t'i përpunojnë informatat dhe të kuptojnë çka kanë lexuar. Disa teknika për ushtrim të leximit dhe zhvillim të rrjedhshmërisë gjatë leximit mund të jenë: ngadalësimi, leximi fjali pas fjalie, bisedë rreth përmbajtjes së asaj që është lexuar etj.
- Leximi në klasë nuk duhet t'u imponohet vetëm që nxënësit të kenë rezultate më të mira gjatë vlerësimit dhe gjatë testeve. Mësimdhënësit duhet ta ndërtojnë vetëbesimin e nxënësve si lexues. Diskutimi i hapur për përmbajtjen e tregimit gjatë së cilës secili koment do të merret parasysh u ndihmon nxënësve të kuptojnë se leximi nuk është garë ose test, por shkathtësi jetësore të cilën e përdorim që të lexojmë informata të reja, të fitojmë njohuri të reja dhe të zbulojmë perspektivë të re. Mësimdhënësit duhet ta vlerësojnë nxënësin në bazë të mundit që e kanë dhënë dhe mendimit që e ka shprehur, e jo vetëm sipas asaj a është e saktë përgjigjja.
- Testet e leximit mund të jenë me format të ndryshëm. Në vend që të zgjedhin përgjigje të saktë nga disa alternativa të dhëna ose të zgjidhin test të njohurive, më mirë është që t'u parashtrohen pyetje ese të hapura. Mund t'u jepet detyrë të gjejnë tre mbiemra të cilët e përshkruajnë ndonjë person dhe të japin shembuj për gjërat të cilat ky person i ka thënë ose i ka bërë për shkak të së cilave e kanë përshkruar me këta tre mbiemra. Pastaj të kërkohet nga ata ta vlerësojnë përfundimin e ndonjë tregimi dhe të sqarojnë pse e kanë vlerësuar pozitivisht ose negativisht.
- Nxënësit mendojnë se ata duhet të lexojnë çdo gjë që u jepet, pa marrë parasysh sa është ajo e gjatë ose e vështirë, prandaj nëse nxënësit janë të detyruar të lexojnë diçka që është mbi mundësitë e tyre ose që nuk është e rëndësishme ose interesante për ata, me këtë do t'u shkatërrohet entuziazmi për lexim. Është mirë që nxënësit vet të zgjedhin çka duan të lexojnë nga disa përmbajtje edukative që u ofrohen.
- Nxënësit kanë frikë se mendimi i tyre do të jetë i gabuar, prandaj mësimdhënësit duhet ta pranojnë çdo mendim, ta shpërblejnë sinqeritetin dhe t'i nxisin t'i zhvillojnë idetë e tyre në mënyrë logjike, koherente dhe kreative. Me pjekjen e tyre dhe me ushtrim, shkathtësitë për lexim dhe shkrim do t'u përmirësohen dhe nxënësit do të mundën më shumë ta çmojnë letërsinë.
- Mësimdhënësit duhet të gjejnë mënyrën t'i grupojnë nxënësit në atë mënyrë që nuk do të varet nga aftësia e tyre e leximit, që t'i largohet etiketimit. Duhet t'u ndihmohet nxënësve të kuptojnë se ekzistojnë lloje të ndryshme të inteligjencës dhe se leximi është vetëm një nga shkathtësitë e shumta, që në vetvete nuk është tregues i inteligjencës.

- Në paralele të kombinuara, në të cilat mësojnë së bashku nxënës të së paku dy klasave, kur mësimdhënësi ligjëron për njëren klasë çdoherë duhet t'i nxisë nxënësit e klasave të tjera të lexojnë në mënyrë të pavarur.
- Mjetet didaktike mund të jenë mjet i fuqishëm për zhvillimin e mendimit matematikor dhe arsyetimin kur përdoren si mbështetje për këto procese, e jo si mjete ndihmëse për të cilët do të mbahemi me këmbëngulje duke ndjekur ndonjë procedurë të vendosur që të vijmë deri te përgjigjja. Prandaj mësimdhënësit duhet t'u sigurojnë nxënësve qasje deri te të gjitha resurset që i kanë në klasë dhe t'u lejojnë vetë të zgjedhin çka do të përdorin që të zgjidhin ndonjë problem. Resurset mund të jenë të ndryshme, sepse për zgjidhje të detyrave të ndryshme mund të përdoren mjete të ndryshme didaktike, por fëmijët vetë duhet të shohin si ato janë të lidhura me numrat dhe operacionet matematikore.
- Nxënësve duhet t'u jepet mundësia t'i tregojnë mësimdhënësit dhe nxënësve tjerë si e kanë zgjidhur një detyrë të caktuar. Hulumtimi, puna e pavarur dhe kreativiteti gjatë zgjidhjes së detyrave të dhëna, duhet të shndërrohet në pjesë përbërëse të kulturës së të nxënësve në klasë.

Në shtëpi:

- Që një fëmijë të mësojë të lexojë rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse është i nevojshme ushtrimi, shumë më shumë se koha që fëmijët e kanë në shkollë. Prandaj, prindërit duhet të angazhohen **në aktivitetet të ndryshme për përvetësim të hershëm të shkrimit leximit** me fëmijët e tyre si lexim i librave, tregimin e përrallave, këndimin e këngëve, bisedës për gjërat që i bëjnë së bashku, bisedë për atë që kanë lexuar, luajtja e lojërave gjuhësore, shkrimi i shkronjave dhe fjalëve, leximi i shenjave dhe mbishkrimeve, krijimi i librave të ilustruar;
- Fëmijët duhet të kenë **qasje deri te materialet e ndryshme për lexim** në shtëpitë e tyre. Nëse në shtëpi nuk ka materiale, prindërit së bashku me fëmijët e tyre duhet ta vizitojnë bibliotekën më të afërt;
- Fëmijët duhet t'i shohin prindërit si lexojnë dhe shkruajnë sepse **shprehia për lexim** mësohet nga njerëzit që i rrethojnë;
- Prindërit duhet rregullisht të informohen **për avancimin** e fëmijës së tyre në lexim dhe mësimdhënësi t'u jep këshilla si ata mund të ndihmojnë.

Shkollat gjithashtu duhet t'u ndihmojnë familjeve nëpërmjet disa strategjive të thjeshta:

- Të ftojë anëtarët e familjes në klasë që të vëzhgojnë si përvetësohen shkathtësitë për lexim dhe shkrim;
- Të organizohen "ditë të familjeve të përvetësimit të shkrimit leximit" ku nxënësit, familjet e tyre dhe anëtarët e bashkësisë do të jenë të përfshirë në aktivitete të ndryshme argëtuese;
- Vazhdimisht t'u jepen informacione prindërve për atë si fëmija avancohet në lexim (jo vetëm në tremujor, gjysmë vjetor ose fund të vitit shkollor);
- Të ftohen anëtarë të familjeve ose bashkësisë të jenë lexues mysafirë. Nxënësit e shkollave të mesme, studentët dhe pensionistët shpesh duan në mënyrë vullnetare të marrin pjesë në aktivitete të tilla;
- T'u jepen nxënësve dhe familjeve listë me libra interesante (jo vetëm lektura të obligueshme) të cilët do të mund t'i lexonin gjatë pushimit veror, me qëllim t'u ndihmohej të ushtronte lexim gjatë verës;
- Të nxiten nxënësit dhe familjet e tyre të huazojnë libra nga biblioteka shkollore të cilat do t'i lexonin në shtëpi së bashku me familjen;

- Të bëhen paketa lexuese për nxënësit. Në ata mund të ketë fletë letre për evidencë të asaj që është lexuar së bashku me familjen e tyre, këshilla për prindërit gjyshërit dhe gjyshet të cilët mund t'u ndihmojnë fëmijëve/nipërve të tyre me lexim dhe aktivitete të ngjashme që bëhen së bashku. Paketa mund të përmban edhe libra të cilët do të mund të ishin të shënuar si “libra që i lexoj vet”, “libra që dikush do t'i lexojë me mua” dhe “libra që dikush do të m'i lexojë mua”.

Në nivel nacional:

- Të hapet dialog me institucionet arsimore për **revidim të programeve mësimore** dhe politikave si dhe zbatimin e tyre në mësimdhënien e lëndëve të gjuhës dhe matematikës në klasat fillestare;
- **Të harmonizohen programet mësimore** të gjuhës dhe matematikës;
- Të përkufizohen **standardet nacionale për arritjet në lexim dhe matematikë** për mësimin në gjuhë maqedonase, shqipe dhe turke për klasat fillestare dhe të përcaktohet deri në cilën shkallë nxënësit e klasave fillestare i arrijnë këto standarde;
- Të realizohet kampanjë nacionale për rritjen e përvetësimit të shkrim leximit në fushë të gjuhës me qëllim që të ngrihet vetëdija dhe të zmadhohet përfshirja e bashkësisë dhe familjeve. Veçanërisht është e nevojshme të kushtohet vëmendje fëmijëve të mjediseve rurale dhe shkollave periferike;
- Të përfshihen shtëpitë botuese nëpërmjet partneriteteve publike – private që të sigurohen libra dhe resurse të tjera për shkollat, bibliotekat dhe familjet më të varfra, në gjuhë të cilën fëmijët e kuptojnë..

6. SHTOJCA 1: DETYRA NË EGRA NË GJUHË SHQIPE

Detyra 1: Njohja e shkronjave dhe shqiptimi i tyre

N	J	v	u	D	k	S	i	B	O
Dh	A	q	R	ll	Y	m	Nj	Z	f
e	X	T	sh	G	ë	Ç	h	L	gj
M	c	N	Th	e	zh	U	d	a	P
V	Xh	L	r	O	F	nj	S	Y	ll
Sh	I	X	J	v	p	K	T	E	z
J	Zh	d	Ë	f	Gj	o	Ll	n	A
I	Q	H	u	Rr	nj	M	y	C	T
b	N	k	A	Dh	r	H	L	i	X
P	Ç	e	D	g	th	U	S	ë	xh

Detyra 2: Shpejtësia e leximit të fjalëve të njohura

ai	dru	hëna	iriqi	Jehona
çorapë	Elena	lule	mot	do
jo	mal	Vesa	notoj	lepuri
vetulla	bukur	Agon	kos	ne
pi	gur	dera	Orhan	detyra
kërkoj	lexoj	puna	unë	po
ti	ora	mali	aroma	Dorina
këndo	banka	lëng	miu	se
me	ose	bora	libri	tigani
banane	shtëpi	nata	dje	ik

Detyra 3 dhe 5: Shpejtësia e të lexuarit të tekstit logjik

Tregimi nr. 1		Pyetje
<p>Me gëzim i prisja pushimet e verës. Xhaxhai e solli kushëririn tim Benin, ashtu siç më kishte premtuar.</p>	18	<p>1. Çka priste me gëzim vajza?</p> <ul style="list-style-type: none"> - pushimet verore - pushimet - verën <p>2. Cili ishte premtimi i xhaxhait?</p> <ul style="list-style-type: none"> - ta sjellë Benin - ta sjellë kushëririn në fshat - ardhjen e Benit në fshat - lojën me Benin
<p>Çdo ditë luanim te lumi i fshatit tonë.</p>	26	<p>3. Ku luanin fëmijët çdo ditë?</p> <ul style="list-style-type: none"> - pranë lumit - në fshat - pranë lumit në fshat
<p>Isha e dhënë pas lojës, kur papritmas dëgjova Benin duke bërtitur. E shqetësuar vrapova drejt tij. Beni nuk është i mësuar me jetën në fshat. Mendova se diçka i ka ndodhur.</p>	57	<p>4. Pas çka ishte e dhënë vajza?</p> <ul style="list-style-type: none"> - pas lojës - vajza ishte e dhënë pas lojës <p>5. Çka dëgjoji vajza?</p> <ul style="list-style-type: none"> - e dëgjoji Benin si bërtiste - e dëgjoji kushëririn duke bërtitur - Benin si bërtiste - zërin e Benit - bërtitjen/klithjen e Benit <p>6. Si veproi vajza kur e dëgjoji bërtitjen e Benit?</p> <ul style="list-style-type: none"> - ajo/vajza vrapoi kah Beni/kushëri - filloi ta kërkojë <p>7. Pse u shqetësua kushërira?</p> <ul style="list-style-type: none"> - për shkak të bërtitjes/klithjes së Benit - u frikësua për Benin - mendoi se diçka i ka ndodhur Benit - mendoi se është lënduar - mendoi se është humbur - mendoi se diçka e tmerrshme i ka ndodhur Benit <p>8. Më çka nuk ishte i mësuar Beni?</p> <ul style="list-style-type: none"> - me jetën në fshat - me lojën jashtë - me lojën pranë lumit - me lojën në natyrë
<p>Kur u afrova, pashë Benin duke luajtur me një breshkë.</p>	67	<p>9. Çka bënte Beni kur kushërira u afrua pranë tij?</p> <ul style="list-style-type: none"> - po luante me një breshkë <p>10. Çka mendon, pse bërtiti Beni?</p> <ul style="list-style-type: none"> - ishte gëzuar - ishte befasuar - ishte frikësuar

		<ul style="list-style-type: none"> - ishte i lumtur - ishte trembur - nga breshka - për herë të parë kishte parë një breshkë
--	--	--

Detyra 4 dhe 6: Të kuptuarit e asaj që është lexuar

Tregimi nr. 2		Pyetje
Jola jeton në një ndërtesë të lartë. Ajo ka shumë miq, por më së shumti ka dëshirë të shoqërohet me gjyshen Sevdie.	22	<p>1. Ku jeton Jola?</p> <ul style="list-style-type: none"> - në ndërtesë - në një ndërtesë të lartë <p>2. Me kë shoqërohet më shumë Jola?</p> <ul style="list-style-type: none"> - me gjyshen Sevdie
Gjyshja ka problem me këmbët prandaj kur ec, dikush duhet ta mbajë përdore.	35	<p>3. Përse gjyshja Sevdie nuk mund të ecë vetë?</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka problem me këmbët - i dhembin këmbët
Në mëngjes, Jola bën pazarin për gjyshen, e pastaj bashkë shkojnë për shëtitje në parkun e afërm. Ato çdo ditë bisedojnë për gjëra të ndryshme. Gjyshja më shumë i tregon ndodhi nga fëmijëria e saj.	70	<p>4. Çka bën në mëngjes Jola për gjyshen Sevdie?</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën pazarin - blen për të <p>5. Ku bëjnë shëtitje Jola dhe gjyshja Sevdie?</p> <ul style="list-style-type: none"> - në park - në parkun e afërm <p>6. Çka i tregon gjyshja Sevdie, Jolës?</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndodhi nga fëmijëria e saj - ndodhi nga jeta e saj
Fëmijët e ndërtesës tallen me të, sepse ajo kujdeset për gjyshen. Mirëpo, fjalët e tyre nuk e brengosin Jolën.	89	<p>7. Përse e tallin Jolën fëmijët e ndërtesës?</p> <ul style="list-style-type: none"> - sepse ajo shoqërohet me gjyshen Sevdie - sepse kujdeset për gjyshen <p>8. Çka mendon Jola për fjalët e fëmijëve të ndërtesës?</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk e brengosin - nuk merakoset - nuk i dëgjon
Ajo ndihet mirë kur është me gjyshen Sevdie, sepse kështu mëson për lojërat nga e kaluara. Jola është krenare për arsye se i ndihmon gjyshes Sevdie.	115	<p>9. Si ndihet Jola kur është me gjyshen Sevdie?</p> <ul style="list-style-type: none"> - bukur - krenare - e kënaqur - e lumtur - e gëzuar - mirë <p>10. Jola është krenare. Pse?</p> <ul style="list-style-type: none"> - i ndihmon gjyshes Sevdie - sillet mirë me të moshuarit - kujdeset për të moshuarit

7. SHTOJCA 2: DETYRA NË EGMA PËR KLASËN E DYTË DHE TË TRETË

Detyra 1: Krahasimi i numrave

Klasa e dytë

5	9
19	14
67	76
25	23
43	33
50	15
88	99

Klasa e tretë

24	34
105	115
46	6
73	37
200	600
406	460
102	98
578	598
777	772
999	100

Detyra 2: Vazhdo vargun (numri që mungon në varg)

Klasa e dytë

3	5	7	[9]
45	50	[55]	60
13	16	19	[22]
[30]	32	34	36
18	17	[16]	15

Klasa e tretë

24	25	[26]	27
52	[54]	56	58
15	18	21	[24]
100	[95]	90	85
[46]	56	66	76
72	[77]	82	87
153	143	133	[123]

Detyra 3: Mbledhja

Klasa e dytë

$3 + 6 = (9)$
$14 + 5 = (19)$
$9 + 11 = (20)$
$90 + 8 = (98)$
$50 + 40 = (90)$
$16 + 8 = (24)$
$45 + 18 = (63)$
$25 + 37 = (62)$
$52 + 14 = (66)$
$68 + 32 = (100)$

Klasa e tretë

$24 + 3 = (27)$
$42 + 8 = (50)$
$119 + 1 = (120)$
$36 + 29 = (65)$
$450 + 50 = (500)$
$57 + 37 = (94)$
$68 + 13 = (81)$
$72 + 35 = (107)$
$85 + 15 = (100)$
$300 + 400 = (700)$

Detyra 4: Zbritja

Klasa e dytë

$13 - 3 = (10)$
$60 - 40 = (20)$
$45 - 8 = (37)$
$80 - 5 = (75)$
$57 - 27 = (30)$
$90 - 71 = (19)$
$29 - 7 = (22)$
$72 - 16 = (56)$
$86 - 24 = (62)$
$100 - 53 = (47)$

Klasa e tretë

$35 - 9 = (26)$
$61 - 2 = (59)$
$79 - 8 = (71)$
$60 - 35 = (25)$
$53 - 47 = (6)$
$96 - 16 = (80)$
$82 - 68 = (14)$
$100 - 46 = (54)$
$370 - 70 = (300)$
$216 - 100 = (116)$

Leximi ju bën udhëheqës

Detyra 5: Detyra tekstuale

Klasa e dytë

Detyra 1:

Në klasë kishte 15 libra. Nxënësit sollën edhe 9 libra. Sa libra ka gjithsej në klasë?

Përgjigje e saktë: 24

Detyra 2:

Artani ka 28 sheqerka. Shokut të tij Danielit, i dha 8 sheqerka. Sa sheqerka i ngelën Artanit?

Përgjigje e saktë: 20

Detyra 3:

Ana ka 9 vjet. Motra e saj është 6 vjet më e madhe se ajo. Sa vjet i ka motra e Anës?

Përgjigje e saktë: 15

Detyra 4:

Berta ka 50 denarë. Bleu një fletore për 17 denarë. Sa denarë i ngelën Bertës?

Përgjigje e saktë: 33

Klasa e tretë

Detyra 1:

Vera zgjidhi 15 detyra. Zana zgjidhi 6 detyra më shumë se Vera. Sa detyra gjithsej ka zgjidh Zana?

Përgjigje e saktë: 21

Detyra 2:

Në ditëlindjen e Stefanit kishte gjithsej 100 tullumbace. Deri në përfundimin e festës plasën 42. Sa tullumbace ngelën të fryrë?

Përgjigje e saktë: 58

Detyra 3:

Në 5 kuti kishte nga 7 ëmbëlsira. Sa ëmbëlsira kishte gjithsej në të gjitha kutitë.

Përgjigje e saktë: 35


Detyra 4:

Agnesa bleu 18 lule. I ndau në 6 vazo. Nga sa lule kishte vendosur Agnesa në çdo vazo?


Përgjigje e saktë: 3

Detyra 6: Njohja e formave gjeometrike


Tregomi dhe numëroji të gjithë rrethet



Tregomi dhe numëroji të gjitha trekëndëshat






Tregomi dhe numëroji të gjitha kënddrejtët



Detyra 7: Vazhdimi i vargut me forma gjeometrike (forma e cila mungon në varg)

Klasa e dytë



Klasa e tretë

